



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI I PERSONELIT

**SHPLLJE PËR POZICION TË LIRË PËR PROCEDURËN E KONKURIMIT
NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL**

Në zbatim të ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të VKM nr. 242 datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, në Vendimin nr.04 datë 09.01.2025 “Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores së Bashkisë Durrës”, si dhe në Urdhrin nr.304 prot 11476, datë 26.09.2025 “Për shpalljen e konkurimit për pozicionet e lira”, në vendimin nr.117 prot 12805, datë 21.10.2025, Bashkia Durrës shpall konkurimin për procedurën nga jashtë shërbimit civil për pozicionin:

DREJTOR PRANË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE SOCIALE

I. PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL

Konkurimi është i hapur për pranimin në shërbimin civil në **KATEGORINË E MESME DREJTUESE**, sipas parashikimeve të VKM nr. 242 datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”,

Kandidatët duhet të plotësojnë **KËRKESAT E PËRGJITHSHME** për pranimin në Shërbimin Civil në përputhje me VKM nr. 242 datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, si më poshtë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji;

g) TË DHËNAT E POZICIONIT TË PUNËS

Emërtesa e pozicionit: Drejtor

Institucioni: Bashkia Durrës

Drejtoria: Drejtoria Shërbimeve Sociale

Raporton tek: Titullari i Institucionit

Qëllimi i Përgjithshëm i Pozicionit të Punës:

Synon në përkrahjen dhe rritjen e ndjeshmërisë njerëzore për integrimin, mbrojtjen dhe lehtësimin e situatës sociale për njerëzit me probleme zhvillimi, me aftësi të kufizuar, të fëmijëve në vështirësi dhe personave të dhunuar.

II.DETYRAT KRYESORE

Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Shërbimit Social janë:

- Programimi dhe kontrolli i përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror.
- Zbutja e varfërisë nëpërmjet dhënies së ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale .
- Administron shërbime shoqërore për individët dhe grupet në nevojë të cilët nuk mund të plotësojnë nevojat bazë jetike.
- Organizon, drejton, koordinon dhe kontrollon punën e zyrës së specialistëve dhe punonjësve që janë nën autoritetin e sektorit të tij .
- Përpilon kërkesën për fondin e Bllok-Skemës së Ndihmës Ekonomike, PAK dhe Inv. Punës.
- Rishikimi i cilësisë së projekt-vendimin për Këshillin Bashkiak .
- Përgjigjet para Kryetarit të Bashkisë dhe Dr. Rajonale të Shërbimit Social për mbarëvajtjen e punës.
- Përgjigjet para titullarit të Bashkisë për problemet e kësaj Drejtorie .
- Bashkëpunon me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror .Proçeset kryesore të Sektorit të Ndihmës Ekonomike
- Krijon marrëdhënie bashkëpunimi me O.J.F. dhe Donatorë të ndryshëm për të rritur shtrirjen , efektivitetin dhe cilësinë e Shërbimeve Sociale.

- Kontrollon punën e sektoreve të veçante.
- Dëgjon dhe impenjohet për zgjidhjen e ankesave të qytetarëve.
- Kryen detyra të tjera mbështetur në ligjet dhe aktet nënligjore, për një punë sa më efektive dhe në shërbim të komunitetit.
- Monitoron punën e institucioneve në varesi, të cilat ofrojnë shërbime përkujdesi.

1. Kushtet për aplikim për procedurën e konkurimit nga jashtë shërbimit civil

Arsimi: *Shkenca sociale, Punë sociale, Psikologji, Sociologji, Juridik, Ekonomik, etj*

2. Dokumentet, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b) Fotokopje të diplomës dhe liste notash (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- c) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet me postë ose dorazi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore apo Zyrën e Protokollit në Bashkinë Durrës në adresën - Bashkia Durrës, Sheshi “Liria”, 2000 Durrës

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve për procedurën nga jashtë shërbimit civil duhet të bëhet brenda datës: **27.10.2025**

3. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën **28.10.2025**, Bashkia Durrës do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al) dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën nga jashtë shërbimit civil si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista

4. Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohen testimi dhe intervista

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

Kodin e Procedurave Administrative

Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar

Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar

Ligji nr. 44/2014 datë 24.4.2014 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”

Ligji nr. 9131 dt. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”

Ligji 139 dt. 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar

Ligji nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

a) Vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar: (15 pikë)

Vlerësimi i jetëshkrimit, eksperiencë, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet positive.

b) Vlerësimi me shkrim: (60 pikë)

c) Vlerësimi gjatë intervistës së strukturuar me gojë: (25 pikë)

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Durrës do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al), dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës jo fitues në këtë procedurë do të njoftohen individualisht për rezultatet në mënyrë elektronike (nëpërmjet adresës së e-mail)